



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI
VENDIM

Nr. 276, Datë 13.12.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “M. C ENERGJI GOJAN” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GOJAN”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, pika 2, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1845/22 prot., datë 11.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p. k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845 prot., datë 30.08.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh,” në zonën e Gojan-Gjegjanit, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 MW.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 202, datë 27.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.10.2024 dhe 02.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2057 prot., datë 08.10.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, ndërsa me shkresën nr. 1845/7 prot., datë 04.10.2024 i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1845/8 prot., datë 16.10.2024, nr. 1845/12 prot., datë 12.11.2024, nr. 1845/13 prot., datë 18.11.2024 dhe nr. 1845/16 prot., datë 27.11.2024.
- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme me shoqërinë, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 259, datë 02.12.2024 u vendos zgjatja deri në 10 (dhjetë) ditë pune e vendimmarrjes së bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845/17 prot., datë 04.12.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se mbetej ende informacion e dokumentacion i paplotësuar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me e-mailin e protokolluar me nr. 1845/20 prot., datë 10.12.2024, për ta informuar për sa konstatuar prej saj. Në përgjigje me e-mailin e protokolluar me nr. 1845/21 prot., datë 10.12.2024, shoqëria ka përcjellë informacion dhe dokumentacion plotësues për këtë aplikim.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmën “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën e Koncesionit e formës BOT me nr. 2515 Rep., nr. 1181 Kol., datë 06.11.2017, “Kontratë koncesioni e formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim) për objektin “Dhënie me koncesion të hidrocentralit Gojan”, të ndryshuar me Kontratën Shtesë të Koncesionit nr. 2 rep., nr.2/3 kol., datë 03.01.2019 dhe me Kontratën Shtesë nr. 1990 Rep., nr. 1465 Kol., datë 07.12.2022;
 - Është pajisur me Lejen e përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor Nr. 1/2 prot., datë 20.04.2021, dhënë nga Këshillit i Basenit Ujor Mat, me afat vlefshmërie sipas kontratës koncensionare;
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 17.10.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtim i HEC Gojan”, për
 - fuqinë 15 MW. Shoqëria ka dokumentuar fillimi e punimeve ë datën 18.01.2024, pra brenda afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Po ashtu, në nenin 5, pika 2 të rregullores së sipërcituar parashikohet se: *për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur.*

- Kontrata e Koncesionit nr. 2515 Rep., nr. 1181 Kol., datë 06.11.2017, e ndryshuar, ka një afat 35-vjeçar dhe konstatohet se shoqëria ka humbur afërsisht 7 vjet e 1 muaj nga periudha koncensionare. Si e tillë periudha e mbetur për licencim është afërsisht 27 vjet e 11 muaj, afat ky i cili përfundon konkretisht më 06.11.2052, ndaj dhe licenca do të jetë e vlefshme deri në këtë datë.
- Në lidhje me vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ajo ka depozituar në ERE dokumentin “Detyrimet në kohë reale”, të datës 10.12.2024, i cili nuk ka nënshkrim dhe vulë të institucionit përkatës, por është i shoqëruar me një vërtetim noterial të njësisë me origjinalin. Vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të depozitohet nga shoqëria në vijim, në kuadër të zbatimit dhe mbikëqyrjes së kushteve të licencës përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh,” në zonën e Gojan-Gjegjanit, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 MW, deri më 06.11.2052.
2. Shoqëria duhet të vendosë në punë hidrocentralin brenda datës 28.11.2025.
3. Ky vendim është objekt rishikimi.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI